




REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. <u>2-D/DPK</u>	Nr. Prot. Br. Prot. <u>01-2913/12</u>
Nr. i faq. Broj stranica <u>02</u>	Data Datum <u>16-08-2012</u>
Nr. pages	Date
PRISHTINË	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosova

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë **02.08.2012**, nxjerr këtë:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-4786/11, për z. *Agim Dervishaj* – Drejtor i Agjencionit Pyjor të Kosovës, për shkak se është shmangur situata me konflikt interesi në të cilën ndodhej ky Zyrtar i lartë publik.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-4786-11, për Zyrtarin e lartë, z. Agim Dervishaj – Drejtor i Agjencionit pyjor të Kosovës, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Pas identifikimit të rastit (Neni 18, pika 1, Ligji Nr.04/L-051), sipas të cilit është konstatuar se; zyrtari i lartë ushtron funksion të lartë publik e njëkohësisht edhe funksion menaxhues në biznes privat, që sipas Ligjit për Parandalimin e konflikt të interesit konsiderohet papajtueshmëri funksionesh, zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese.

Pas kësaj shkrese njoftuese, zyrtari i lartë, z. Agim Dervishaj, është paraqitur në Agjencinë kundër Korrupsionit, dhe në takim me zyrtarët e Agjencisë është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet, si dhe për mënyren e shmangies së saj.

Pas këtij takimi, zyrtari i lartë, z.Dervishaj, me datën 27.07.2012, në Agjencinë kundër Korrupsionit, bashkë me një shkresë përcjellëse, ka sjellur dokumentin zyrtar nga ARBK-ja me informacionet mbi biznesin "Dervishaj" Sh.p.k., në të cilat shihet se ai është tërhequr nga ushtrimi i mëtejshëm i funksionit të personit të autorizuar të këtij biznesi.

Kështu, me këto informacione zyrtare, kemi konstatuar se është shmangur situata e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, gjithnjë duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.04/L-051) .

II. Në pajtim me nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit. Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)
- Z./znj. (zyrtari kontaktues)

Drejtore Agjencisë Kundër Korrupsionit

Hasan Preteni /

